



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 101

Tiranë – E enjte, 24 qershor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 71/2021, datë 27.5.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 20, datë 5.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”..... 9731
Ligj nr. 72/2021, datë 27.5.2021	Për një ndryshim në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 9731
Vendim i Kuvendit nr. 60/2021 datë 24.6.2021	Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit <i>ad hoc</i> me 12 anëtarë për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë Zëvendësues për Pozicionet Komisioner të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisioner Publik..... 9732
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 22.6.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.764, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit fillor “Scuola Italiana a Tirana”” 9733
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 375, datë 23.6.2021	Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera që ruhen e mbrohen nga Garda e Republikës..... 9734



LIGJ
Nr. 71/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 20, DATË 5.5.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË
NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 20, datë 5.5.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 27.5.2021

Nr.	Nr. i fushës/kategorisë	Lloji i kategorisë	Fusha/kategoritë e veprimtarive dhe/ose të të mirave publike e të përdorimeve të tyre
	Fusha XIV		Teknologji Financiare (<i>Fintech</i>) dhe TIK
48	1.	Licencë	Shërbime të lidhura me tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë.
49	2.	Licencë	Për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

**Neni 2
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.5.2021

LIGJ
Nr. 72/2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10
081, DATË 23.2.2009, “PËR LICENCAT,
AUTORIZIMET DHE LEJET NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në fund të shtojcës që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e tij shtohet fusha XIV “Teknologji financiare (*Fintech*) dhe TIK” me këtë përmbajtje:

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**



VENDIM
Nr. 60/2021

PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E
KOMISIONIT AD HOC ME 12 ANËTARË
PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE
PËR ANËTARË ZËVENDËSUES
PËR POZICIONET KOMISIONER TË
KOMISIONIT TË PAVARUR
TË KUALIFIKIMIT DHE KOMISIONER
PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me propozimet e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijimin e Komisionit Parlamentar *ad hoc* për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë Zëvendësues për Pozicionet Komisioner të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisioner Publik.

II. Përbërja e Komisionit Parlamentar *ad hoc* për Përzgjedhjen e Kandidatëve është si më poshtë:

a) Nga grupet e shumicës parlamentare caktohen deputetët:

1. Ulsi Manja	Kryetar
2. Klotilda Bushka	Anëtar
3. Alket Hyseni	Anëtar
4. Adnor Shameti	Anëtar
5. Vasilika Hysi	Anëtar
6. Elena Xhina	Anëtar

b) Nga grupet e pakicës parlamentare caktohen deputetët:

1. Myslim Murrizi	Nënkryetar
2. Nimet Musai	Anëtar
3. Edmond Stojku	Anëtar
4. Arlind Çaçani	Anëtar
5. Halil Jakimi	Anëtar
6. Klajdi Qama	Anëtar

1. Edmond Leka anëtar zëvendësues
2. Arben Elezi anëtar zëvendësues

III. Përzgjedhja dhe votimi në Komisionin *ad hoc* bëhet nga lista për votim e përcjellë nga Komisioni *ad hoc* për Verifikimin e Kandidatëve me shkresën nr. 1553/5 Prot., datë 31.5.2017, nëpërmjet një sistemi elektronik që mundëson votimin e fshehtë, ku secili anëtar voton për një kandidat.

IV. 1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit verifikon nëse kandidatët e listës për votim, të përcjellë nga Komisioni *ad hoc* për Verifikimin e Kandidatëve gjatë vitit 2017 shprehin ende interes për të qenë kandidatë në këtë proces, si dhe nëse plotësojnë kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit sipas përcaktimeve në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për periudhën 2017-2021 si më poshtë:

a) ndaj kandidatit nuk ka nisur një hetim penal, nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose nuk ka qenë subjekt i ndalimeve të parashikuara në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

b) kandidati nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike;

c) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit;

ç) kandidati nuk ka qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit;

d) kandidati nuk ka qenë ekspert i caktuar nga partitë politike, si dhe nga ministri i Drejtësisë;

dh) kandidati nuk është më shumë se 65 vjeç.

2. Për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të paragrafit IV të këtij vendimi, kandidati dorëzon në Kuvend brenda afatit të njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shprehjen e interesit dhe deklarin e nënshkruar prej tij, me anë të të cilit deklaron mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar. Deklarimi i rremë përbën shkak për përgjegjësi penale sipas ligjit.



3. Mosshprehja e interesit nga ana e kandidatit, si dhe mosdorëzimi i vetëdeklarimit prej kandidatit brenda afatit të njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, sipas përcaktimeve të pikës 2 të paragrafit IV të këtij vendimi, përbën shkak për heqjen e kandidatit nga lista për votim.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për ngritjen e sekretariatit teknik që do të mbështesë punën e Komisionit dhe funksionimin e sistemit elektronik, që mundëson votimin e fshehtë të emrit/emrave të anëtarëve zëvendësues, në zbatim të kërkesave të nenit 10 të ligjit nr. 84/2016.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 24.6.2021

VENDIM
Nr. 372, datë 22.6.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR.764, DATË 20.12.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E
INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT
PARAUNIVERSITAR TË ARSIMIT
FILLOR “SCUOLA ITALIANA
A TIRANA””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.764, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet: “Për dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë “**Scuola Italiana a Tirana**””.

2. Kudo në përmbajtje të vendimit, fjalët “arsim fillor” zëvendësohen me “arsim bazë”.

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë “Scuola Italiana a Tirana” ushtron veprimtarinë arsimore në adresën: rruga “Rauf Fico”, ndërtesa 11, njësia nr.5, 1022, Tiranë.”.

4. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Në institucionin arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë “Scuola Italiana a Tirana” mësimi do të zhvillohet edhe në gjuhë të huaj (në gjuhën italiane). Lëndët “Gjuha shqipe”, “Historia e kombit shqiptar” dhe “Gjeografia e Shqipërisë” zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.”.

5. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Subjekti, para hapjes së çdo klase të arsimit të mesëm të ulët dhe fillimit të veprimtarisë për këtë nivel arsimor, deklaron në ministrinë përgjegjëse për arsimin, 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës, personelin mësimdhënës për këto klase dhe çdo ndryshim tjetër, duke përcjellë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas përcaktimeve të vendimit nr.466, datë 10.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj”.

Institucioni mund të fillojë veprimtarinë për klasat e arsimit të mesëm të ulët, për vitin shkollor, vetëm pas miratimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin për personelin mësimdhënës dhe çdo ndryshimi tjetër.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë “Scuola Italiana a Tirana” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**VENDIM****Nr. 375, datë 23.6.2021****PËR PËRCAKTIMIN E
PERSONALITETEVE DHE OBJEKTEVE
TË TJERA QË RUHEN E MBROHEN
NGA GARDA E REPUBLIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, pikat 1, shkronja “d”, e 2, shkronja “d”, të ligjit nr.33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Garda e Republikës ruan dhe mbron këto personalitete:

a) Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Shqipëri.

2. Garda e Republikës ruan dhe mbron këto objekte:

a) Objektet ku akomodohet dhe ushtron veprimtarinë personaliteti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë